

STATUTI
I SHOQERISË TREGTARE

" Keshtjella Xhafa Agroturizem" SH.P.K

Në këtë statut:

‘Ligji’ është Ligji Nr.9901, Dt. 14.04.2008 “Për Tregëtarët dhe Shoqëritë tregëtare.
“Statuti” është Statuti i Shoqërisë.

I. DISPOZITA TË PERGJITHSHME

Shoqëria **“Keshtjella Xhafa Agroturizem”** Sh.p.k rregullon pozitën e saj juridike, llojin e shoqërisë, marrëdhëniet e themeluesve, të organëve të saj, kohëzgjatjen e veprimtarisë së saj, marrëdhëniet me të punësuarit, duke u bazuar në ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për Tregëtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodin e Punës, si dhe dispozitat e tjera të legjislacionit shqiptar në fuqi që rregullojnë marrëdhëniet e Shoqërive Tregtare.

Neni 1

Data e themelimit

Sot, Shkodër më Dt. 26.06.2023, unë themeluesi **Agim Xhafa**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 10/09/1981, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 037033693 dhe Nr. Personal *I109100510*, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin **“Keshtjella Xhafa Agroturizem”**.

Neni 2

Objekti i veprimtarisë:

Objektivi i shoqërisë do jetë aktiviteti në fushën e: Bar Restorant. Agroturizem. Grumbullim dhe perpunim të qumeshtit, frutave e perimeve, mishit, etj. Bujtine. Hotel dhe shërbime akomodimi. Shitje, bleje dhe eksport të produkteve dhe nenprodukteve bujqesore e blegtorale. Shërbime katering dhe organizim evente.

Neni 3

Emri dhe selia e Shoqërisë

Shoqëria del në qarkullim me emrin **“Keshtjella Xhafa Agroturizem”**.

Selia e Shoqërisë ndodhet në qytetin e Koplikut me adresë: Malësi e Madhe, Bogic Palvar, Nr.pasurie 1663/2, zona kadastrale 1238.

Neni 4

Kohëzgjatja e Shoqërisë

Afati kohor i zhvillimit të aktivitetit është i pakufizuar dhe fillon me regjistrimin e shoqërisë në Regjistrin Tregtar. Ortakët e Shoqërisë mund të vendosin kufizimin e afatit të veprimtarisë dhe me pas zgjatjen e saj një apo disa herë, sipas një vendimi të posaçëm.

Neni 5

Regjimi Juridik i Shoqërisë

Shoqëria udhëhiqet nga parimet e ekonomisë së tregut dhe ka për qëllim fitimin. Ajo respekton parimin e reciprocitetit.



Ajo është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (Sh.p.k.). Veprimtaria e saj i nënshtrohet dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit si dhe dispozitave të legjislacionit në fuqi. Me vendim të Asamblesë së Përgjithëshme, shoqëria mundet që të ndryshojë regjimin juridik të saj në përputhje me dispozitat ligjore që do të jenë në fuqi si dhe në përputhje të plotë me dispozitat e Aktit të Themelimit dhe të Statutit të saj, duke bërë edhe përshtatjen e tyre sipas ndryshimeve përkatëse.

Shoqëria gëzon personalitet juridik nga data e rregjistrimit të saj në Rregjistrin Tregtar. Shoqëria do të ketë vullnetin e saj.

II. TË DREJTAT DHE DETYRAT E ORTAKËVE

Neni 6

Pasuritë e krijuara nga Shoqëria gjatë aktivitetit të saj janë në pronësi të ortakëve themelues të shoqërisë në përpjestim të drejtë me kuotat që zotërojnë. Ato (pasuritë) mund të tjetërsohen, të jepen me qera, të lihen peng në hipotekë me miratimin e Ortakëve.

Neni 7

Të drejtat dhe detyrimet e Ortakëve

Ortakët japin kontributin në shoqëri në para apo në natyrë, sipas mënyrave dhe afateve të përcaktuara në statut. Ata përgjigjen ndaj shoqërisë personalisht dhe në mënyrë solidare për dëmet e shkaktuara nga mospërbushja e këtyre detyrimeve apo nga përmbushja e tyre përtej afateve përkatëse.

Personi/at përgjegjës për administrimin e shoqërisë informojnë ortakët për ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare dhe me kërkesën e tyre, duhet t'u vënë në dispozicion llogaritë vjetore, përfshirë llogaritë e konsoliduara, raportet për gjendjen dhe ecurinë e veprimtarisë së shoqërisë tregtare, raportet e organeve drejtuese apo të ekspertëve kontabël të autorizuar, si dhe çdo dokument tjetër të brendshëm të shoqërisë, me përjashtim të rastit të sekretit tregtar, i cili është një e dhënë e vlerësuar nga shoqëria si informacion i brendshëm apo dokument që shoqëria mbron, i cili në rast se do tu përhapej personave të pa autorizuar do të shkaktonte dëm të konsiderueshëm interesave tregtare të shoqërisë.

Ortakët veprojnë duke marrë parasysh interesat e shoqërisë. Ortakët respektojnë detyrimet që burojnë nga Akti i Themelimit dhe Statuti. Ata përpiqen për fillimin e aktivitetit të Shoqërisë sipas objektit të veprimtarisë së saj.

Neni 8

Abuzimi i ortakëve ndaj shoqërisë

Ortakët e shoqërisë tregtare që kryejnë një apo më shumë nga veprimet ose mosveprimet vijuese, përgjigjen personalisht ose në mënyrë solidare për detyrimet e shoqërisë, me të gjithë pasuritë e tij nëse:

- a. Abuzojnë me formën e shoqërisë tregtare dhe paraqitjen e qëllimeve të paligjshme
- b. Trajtojnë pasuritë e shoqërisë tregtare si të ishte pasuri e tij;
- c. Në rastin kur kanë marrë apo duhet të kishin marrë dijeni për gjendjen e paaftësisë paguese të shoqërisë, nuk marrin masat e nevojshme për të siguruar që shoqëria, në varësi të llojit të veprimtarisë së ushtruar, të ketë kapitalet e mjaftueshme. Për të përmbushur detyrimet e marra përsipër ndaj palëve të treta.

Neni 9

III. KUSHTET EKONOMIKE TË SHOQERISË

Veprimtaria e funksionimit të Shoqërisë bazohet në kërkesat e ekonomisë së tregut. Veprimtaria ekonomike ndërtohet mbi parimet e llogarisë dhe paqyrohet në bilancet e saj.

Neni 10

Kapitali i Shoqërisë dhe Ortakët

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100,000 (Njëqind mijë) lekë, i ndarë në 1 kuotë e cila ka vlerën 100,000 lekë.

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare me emrin “**Keshtjella Xhafa Agroturizem**” Sh.P.K zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

Agim Xhafa, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 10/09/1981, lindur në Shkodër, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 037033693 dhe Nr. Personal *1109100510* zotëron 1 kuotë duke përfaqësuar 100% të kapitalit ku një kuotë ka vlerën 100,000 lekë.

Kapitali themeltar do të shlyhet plotësisht në para nga Ortaku me themelimin e Shoqërisë. Përgjegjësia e ortakëve shtrihet deri në shumën e kontributeve në kapitalin themeltar.

Neni 11

Pronësia mbi kuotat

Kuotat e kapitalit dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre fitohen ose kalohen nëpërmjet kontributit në kapitalin e shoqërisë:

- a) Me shit-blerjes
- b) Me trashëgimi
- c) Me dhurim
- d) Me çdo menyrë tjetër të parashikuar më ligj

Neni 12

Pavarësisht nga mënyra e fitimit apo kalimit të kuotave, është i nevojshëm miratimi i Asamblesë së Përgjithshme të Ortakëve i përbërë nga ortakët themelues të shoqërisë.

Neni 13

Forma e transferimit

Transferimet e kapitalit themeltar duhet të vërtetohen sipas ligjit, pasi ndryshe janë të pavlefshme.

Neni 14

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali themelor mund të zmadhohet ose të zvogëlohet nga Asambleja e Përgjithshme. Zmadhimi i kapitalit mund të vendoset kur e kerkojnë interesat e Shoqërisë duke vendosur kuotat suplementare të Ortakëve.

Asambleja e Përgjithshme vendos për zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të Shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit nuk duhet të demtojë kreditorët e as të krijojë pasiguri tek këta, ose që kanë dhënë kredi para publikimit të zvogëlimit të kapitalit.

Neni 15

Fondet rezervë

Shoqëria krijon fondin rezervë dhe fondet e tjera financimi për të përballuar nevojat e saj ekonomike.



Ajo disponon lirisht mjetet e veta financiare për shlyerjen e detyrimeve gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 16

Përdorimi i të ardhurave neto

E ardhura neto që realizohet mbasi zbritën shpenzimet e bëra për kryerjen e çdo lloj aktiviteti, nga zbritja e vlerës së amortizimit, nga tatimet dhe taksat, nga kuota që rrjedhin nga kreditë për investime, paga, shpërblime, u kalojnë në pronësi ortakëve në përpjestim të drejtë me kuotat që kanë në shoqëri dhe përdoren prej tyre për qëllime të veta.

Neni 17

Bilanci

Pasuria e Shoqërisë vlerësohet në bilancet e saj në monedhën e vendit ose në monedhë të huaj, sipas vlerësimit të Asamblesë së ortakëve ose ekspertëve në momentin e Themelimit të Shoqërisë.

Bilanci vjetor paraqitet brenda datës 31 Mars të vitit pasardhës. Forma e bilancit përcaktohet nga Administratori në harmoni me formatet e bilanceve të vendosura në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacion fiskal në fuqi.

Neni 18

Plani financiar

Plani financiar parashikon aktivin e pasivin e aktivitetit ekonomik të Shoqërisë të shprehur në lekë ose valutë të konvertueshme. Llogaria ekonomike do të mbahet në Shqipëri. Shkëmbimi i monedhës shqiptare me atë të huaj dhe anasjelltas bëhet sipas kursit zyrtar ose privat të këmbimit.

Neni 19

Shpërndarja e fitimeve

Ortakët kanë të drejtë të mbajnë pjesën e fitimit të deklaruar të pasqyrat financiare të shoqërisë.

IV. ORGANET E SHOQËRISË

Neni 20

Asambleja e Përgjithshme

Organi themelor i shoqërisë është Asambleja e Përgjithshme e përbërë nga Ortakët e shoqërisë. Asambleja e Përgjithshme merr vendime për:

- Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- Ndryshimet e statutit
- Emërimin e shkarkimin e administratorëve
- Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- Përcaktimin e shpërblimeve për administratorin/ët, likuiduesin dhe ekspertët kontabël të autorizuar.
- Mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët. Përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë.
- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
- Pjestimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
- Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- Miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

- Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Neni 21

Asambleja e Përgjithshme mblidhet sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e asamblesë së përgjithshme thirret jo më pak se një herë në vit. Asambleja e përgjithshme thirret nga administrator/ët apo nga ortakët e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme thirret nëse:

- Sipas bilancit vjetor apo raportëve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

Neni 22

Thirrja e Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet njoftimit shkresor ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi shkresor apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës dhe i dërgohet ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Neni 23

Vendim-marrja

Të gjitha vendimet merren nga asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë.

Neni 24

Procesverbal i mbledhjes së asamblesë

Të gjitha vendimet e Asamblesë së Përgjithshme duhet të regjistrohen në Procesverbal. Administratori/ët kujdeset dhe përgjigjet për ruajtjen e kopjes së procesverbalit të mbledhjes së asamblesë.

Proces Verballi duhet të përmbajë datën, vendin, orën, rendin e ditës, emrin e kryetarit e të mbajtësit të Proces-Verballit, rezultatet e votimit.

Proces-Verballit i bashkëlidhet edhe lista e pjesëmarrësve, si dhe akti i thirrjes së asamblesë së përgjithshme.

Proces-Verballi i mbledhjes nënshkruhet nga ortakët dhe nga mbajtësi i procesverballit.

V. ADMINISTRIMI I SHOQËRISË

Neni 25

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona si administrator të shoqërisë. Afati i emërimit nuk duhet të jetë më i gjatë se 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekt pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Statuti mund të vendosë rregullat e posaçme për emërimin e administratorëve.

Administrator caktohet **Z.Jonilda Cufaj**, shtetas shqiptar, i ditëlindjes 28/04/1996, lindur në Koplik, mbajtës i letërnjoftimit me Nr 038849491 dhe Nr. Personal J65428057P me një mandat 5 vjeçar dhe ka të drejta totale përfaqësimi të kompanisë.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori, i cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e

Shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 26

Të drejtat dhe detyrimet e administratorit

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikën tregtare të vendosura nga Asambleja e Përgjithshme.
- Përfaqëson shoqërinë tregtare.
- Kujdeset dhe është përgjegjës për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumentëve dhe librave kontabël të shoqërisë.
- Përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor. Bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara asamblesë së përgjithshme për miratim.
- Krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- Kryejë regjistrimet dhe dergojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, sipas ligjit për Qendrën Kombëtare të Biznesit.
- Raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregëtare.
- Kryen/jnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
- Të thërrasin asamblenë e përgjithshme kur shoqëria brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, që kanë vlerë me të lartë se 5 përqind të asetëve të shoqërisë, që rezultojnë në pasqyrat e fundit financiare të çertifikuara dhe kursi pas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezultojnë ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.

VI. MARRËDHËNIET E PUNËS

Neni 27

Marrëdhëniet e punës në Shoqëri rregullohen sipas dispozitave të Aktit të Themelimit, Statutit dhe Legjislacionit Shqiptar të Punës.

Punësimi në Shoqëri realizohet me anë të kontratës individuale të punës midis Shoqërisë e të punësuarve. Marrëdhëniet midis Shoqërisë e sindikatës rregullohen nëpërmjet kontratës kolektive të punës.

Neni 28

Të punësuarit dhe punonjësit drejtues administrativ janë përgjegjës për dëmet që shkaktojnë Shoqërisë për faj të tyre dhe përgjigjen para saj civilisht apo penalisht.

VI. PRISHJA E SHOQËRISË / LIKUJDIMI

Neni 29

Kjo Shoqëri do të priset në rast kur Asambleja e Përgjithshme vendosë për prishjen e Shoqërisë duke emëruar një ose më shumë likuidues.

Prishja e shoqërisë regjistrohet në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit nga administratori.

VII. DISPOZITAT E FUNDIT

Neni 30

Ky Statut hyn në fuqi pas miratimit dhe regjistrimit të Shoqërisë në regjistrin tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Neni 31

Gjithcka që nuk është parashikuar shprehimisht në këtë Statut do të rregullohet me parimin e mirëkuptimit dhe të sjelljes së mirë si dhe nga legjislacioni tregtar dhe ligje të tjera të lidhura me të në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

Neni 32

Ky Statut përpilohet në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe dhe u nënshkrua pa vërejtje nga ortakët themelues.

ORTAKËT THEMELUES

Agim Xhafa

